

Tri fytyrat e kaosit digjital

Irena Myzeqari

Nga Gutenbergu te ZuckerBergu duket se bota ka ndryshuar për të mbetur njëlloj. Pavarësisht epokës, njeriu i mesjetës, i botës moderne apo post-moderne, ka nevojë të informohet dhe të komunikojë. Por nëse Bergu i parë, *e çliroi* informacionin prej ngurtësisë së pergamenave, Bergu i dytë i ka dhënë gjithkujt mundësinë të ndihet i plotfuqishëm prej zotërimit, publikimit dhe diseminimit të informacionit nga një skutë e globit, në të gjithë anët e tij.

Për Richard Hornik, kjo *omnipotencë* nuk vjen pa të liga. Sipas tij, sot e vështirë të dallosh a të ndash të vërtetën nga faktet e fabrikuara, sepse teknologjia i ka bërë të gjithë *viktima* të garës së shpejtësisë. Ne duam informacion, e duam shpejt, e duam tani! Por në garën midis shpejtësisë dhe cilësisë, kjo e dyta nuk ka mundësi tjetër veç *të bëhet kurban* i epokës digjitale, duke krijuar kushtet ideale për një botë kaotike, kaos i cili tingëllon e projektohet më i frikshëm se ai i Parakrijimit, më i frikshëm se ai i Dekikës përfundimtare.

Fytyrat e kaosit digjital

Kaosi ka fytyrë e emër në epokën digjitale; ai vjen me fytyrën e Fake News ose ndryshe “informacionit të fabrikuar që imiton formalisht strukturën e lajmit por jo përmbajtjen, organizimin dhe qëllimin e tij. Fytyra tjetër është më shkatërruese, sepse vjen në formën e informacionit fals, e quhet Dezinformim, dhe krijohet me qëllimin e vetëm për të bërë keq ose dëmtuar entitetin ndaj të cilit adresohet. E fundit, por jo më pak e rrezikshme është Propaganda, si amalgamë e dy fytyrave të para.

Propaganda ushqehet prej të dyjave e mbahet gjallë prej nevojës sonë për të dëgjuar informacione, të cilat përforcojnë bindjet tona. Njeriu digjital nuk beson më te miti i Faustit, i cili shiti shpirtin për pakëz më shumë dije, për pakëz më shumë informacion. Në kohën kur ka mundësi të diversifikojë pikëpamjet dhe këndvështrimet për politikën, shoqërinë, dhe njerëzimin, njeriu i sotshëm udhëhiqet nga parimi i vetizolimit, i bindur se po ruan shpirtin prej Mefistofeli, i cili është më i gjallë se kurrë, i sendërtuar në një tjetër dimension; Rrjeti Social!

The social dilemma

Në librin e tij “Arti i Luftës”, Sun Tzu i këshillonte gjeneralët të përdornin zhurma të fuqishme dhe hutime të tjera për të *çorientuar* armikun. Në epokën digjitale, strategjia mesa duket vijon të mbetet po ajo, kanë ndryshuar vetëm teknikat; teknologjia është sot operacioni psikologjik dhe arma më e sofistikuar e shtetit modern. Do të ishte naive nga ana jonë të besojmë se rrjetet sociale janë vetëm një platformë që mundëson komunikimin ndërpersonal. Mjafton t’u referohemi fushatave zgjedhore nëpër botë, prezencës së grupeve ekstremiste nëpër faqe të ndryshme online, krijimi i radhëve të ekstremit të majtë apo të djathtë etj., të gjitha evidenca se rrjetet sociale janë platforma më e madhe politike dhe reklamuese e epokës sonë.

Edward Bernays kur flet për propagandën thotë pikërisht se “ata që manipulojnë janë pjesë e një mekanizmi të fshehur social, një lloj qeverie e padukshme, e cila është fuqia e vërtetë drejtuese e vendit. Ne kontrollohemi më kollaj, me mendjet lëshim, me shije e ide të gatshme, pjesa më e madhe të krijuara e të fabrikuara prej njerëzish, të cilët nuk e dimë nëse ekzistojnë vërtet”. Një propagandë e mirë është e thjeshtë, emocionale në dukje e përmbajtje, bazuar në slogane, të cilat ngjisin e përhapen lehtë, ndaj rrjetet sociale janë parajsë mbi tokë, ku Propaganda, miksuar me Fake News e Dezinformim të ngjisë lehtësisht e të përhapet si era. Sa më e madhe gënjeshtër, aq më e besueshme! Sa më shumë share, likes, attend, hashtags, aq më shumë njerëz janë infektuar!

News, Media, Digital Literacy, në kërkim të kurës

Si mund të fitosh një luftë me armiqtë e padukshëm? Duke ndërjegjësuar viktimat! Dhe viktimat jemi ne, secili prej nesh, edhe ata të cilët mendojnë se kanë parzmore për t’u mbrojtur. Lufta me këtë armik kërkon përgjigje të integruar, duke u fokusuar në tre elemente, të cilat janë edhe ilaçi ndaj këtij infektimi modern.

Së pari, edukimi. Edhe pse është kthyer në klishe se edukimi mund të çojë përpara një shoqëri, ka diçka të vërtetë në të. Injoranca është nëna e së keqes dhe nëse duam të aftësojmë njerëzit të ruhen prej tri fytyrave të kaosit, fillimisht t’i mësojmë se kush janë ato. Ky lloj edukimi është garanci për një përdorim më të zgjuar të medias tradicionale dhe asaj alternative.

Së dyti, struktura e medias. Duket se media e shijon këtë lloj konfuzioni. Për ca klikime më shumë, për ca reklama më shumë apo për ca ndjekës më shumë, pranojnë të bëjnë fli idealet e

një profesioni kaq të bukur si gazetaria. Ndaj nuk mund të ketë audiencë të edukuara nëse nuk ka një media e cila beson te fuqia e së vërtetës, sado absolutist të tingëllojë ky koncept. Pajisja e medias me *mbrojtës* prej tri fytyrave, është garanci për shpërndarjen e informacioneve cilësore, të cilat i çojnë njerëzit drejt reagimeve proaktive në mënyrën sesi ata e përdorin median dhe informacionin në përditshmëri.

Së treti, liria e shprehjes. Në një botë ku ka shumë fjalë, ka shumë pak liri për ta thënë atë. Timothy Garton Ash thotë se bota jonë është e mallkuar dhe e bekuar me komunikimin e shpejtë; e bekuar se çdo gjë ndodh në kohë reale, e mallkuar se përgjigjet nuk janë të mirëmbenduara, por më shumë i ngjajnë reagimeve luftarake, aty për aty, e dhëmb për dhëmb. Le të hedhim një hap pas! Të marrim frymë! Të mendojmë! Pastaj nëse jemi gati për ta thënë, liria e fjalës sonë të mos cenohet prej askujt, madje as nga vetja jonë.

Për ta mbyllur ku e nisëm, njeriu i çdo kohe ka nevojë për tjetrin; nevoja për komunikim dhe kuptim është ndër instinktet bazë me të cilin vijmë në jetë. Ndaj për të mos cenuar komunikimin, le të garantojmë informacion të saktë, të bazuar në fakte dhe të vërteta, si mundësia e gjeneratës sonë për të bërë diçka më të madhe sesa thjesht marrja frymë e *dendja* e mendjes me ato që na shpien në hutim.



Kjo rubrikë është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian. Përgjegjësia e vetme për përmbajtjen e këtij dokumenti është e Institutit Shqiptar të Medias dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se reflekton pozicionin e Bashkimit Europian.



The regional program "Media for Citizens – Citizens for the media: Strengthening the Capacity of NGOs for the Development of Media and Information Literacy in the Western Balkans" is implemented with the support of the European Union by partner organizations Mediacentar Sarajevo, Albanian Media Institute, Macedonian Institute for Media, Montenegrin Media Institute, Novi Sad School of Journalism, Peace Institute, SEENPM